

RAPORTI PËR KONFERENCË

Politika kulturore apo politika me kulturë

Dhjetor 2015, Prishtinë



**FORUMI
KULTUROR**

Rrjeti i organizatave të pavarura

Rrjeti i organizatave të pavarura të
kulturës të Kosovës

www.forumikulturor.net



**FORUMI
KULTUROR**

Rrjeti i organizatave të pavarura të kulturës të Kosovës

Rrjeti i organizatave të pavarura të kulturës të Kosovës
www.forumikulturor.net

Prodhimi i këtij dokumenti është mundësuar me ndihmën e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, dhe Olof Palme International Center e mbështetur nga Qeveria Suedeze.

“Ky publikim u prodhua me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Forumit Kulturor dhe në asnjë mënyrë nuk paraqet mendimet e Bashkimit Evropian”

RAPORTI PËR KONFERENCË

Politika kulturore apo politika me kulturë

Autore:

Zana Sokoli



Projekt i financuar nga BE-ja
dhe i menaxhuar nga Zyra e
Bashkimit Evropian në Kosovë



SWEDEN

Tabela e përmbajtjes

Për konferencën

Gjendja e tanishme

Diskutimi në panelin e konferencës

Përfundim

Forumi Kulturor

Për konferencën

Konferenca vjetore e Forumit Kulturor është mbajtur më 27 nëntor 2015 në Prishtinë. Diskutimet e konferencës janë mbajtur në Panel, ku është analizuar çështja e politikave kulturore dhe ndërhyrjeve të politikës në kulturë gjatë viteve të fundit. Në panelin e konferencës, përfaqësuesit e Qeverisë, të skenës së pavarur kulturore dhe ekspertët ndërkombëtarë kanë diskutuar zhvillimet në lëmin e kulturës gjatë dy viteve të fundit, me fokus të veçantë në zhvillimin e politikave (strategjive) të kulturës, shpërndarjen e mjeteve financiare për kulturë, dialogun e strukturuar mes Qeverisë dhe shoqërisë civile dhe në aktivitetet e ardhshme për avancimin e agjendës kulturore në Kosovë.

Gjendja e tanishme

Në raportin e tyre hulumtues për Forumin Kulturor, Ebba Lekval dhe Shqipe Hajredini nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike argumentojnë se i vetmi dokument në Kosovë ku përmendet një lloj i objektivave për sektorin e kulturës është Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASh), edhe duhet të thuhet se në dokumentin 226-faqësh vetëm dy faqe i janë dedikuar kulturës. Në KASh-in e viteve 2015–2017, Qeveria thekson se misioni i MKRS-së është ‘krijimi dhe zhvillimi i politikës, mjedisit dhe mekanizmave të duhur për promovimin e aktiviteteve kulturore’. Më pas, renditen disa objektiva, duke përfshirë përkrahjen për institucionet publike të kulturës dhe sektorin e pavarur të kulturës.¹ Për të arritur këtë objektiv, Qeveria do të përkrahë institucionet publike të lidhura me kulturën, do të përkrahë kulturën e pavarur dhe avancojë diplomacinë kulturore përmes infrastrukturës së përmirësuar kulturore.

1 ‘Korniza afatmesme e shpenzimeve 2015–2017’, Ministria e Financave, Prill 2014, http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Korniza_Afatmesme_e_Shpenzimeve_2015_-_2017.pdf, p. 74–75.

Veprimet specifike të renditura përfshijnë ‘përkrahjen e institucioneve të kulturës në kreativitetin e tyre kulturor në: teatro, muzikë, film, arte pamore, vallëzim dhe literaturë.² Për të plotësuar KASh-in, në Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës 2015–2018 (Programi i Qeverisë) parashihet rritja e financimit si për palët publike, ashtu edhe për ato të pavarura të kulturës, reforma e legjislacionit dhe përmirësimi i infrastrukturës fizike.³

Në Programin e saj për vitet 2015–2018 Qeveria e re ka deklaruar se do të hartohet strategjia për kulturë.⁴ Për këtë qëllim është themeluar një grup punues i përbërë prej 25 anëtarësh,⁵ dhe ka filluar procesin e hartimit.⁶ Disa nga të interv-

2 *Po aty*.

3 Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2015–2018, i miratuar në shkurt 2015, http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Government_Programme_2015-2018_eng_10_mars.pdf, p. 68–70 [Programi i Qeverisë].

4 *Po aty*, f. 69.

5 Intervistë me Vehbi Miftarin, këshilltar i lartë politik, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, 27 korrik 2015.

6 Intervistë me Valon Kashtanjevën, drejtor, Zyra për të drejtën e autorit dhe të drejtat e ndërlidhura, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, 10 qershor

istuarit kanë kritikuar qeverinë për mosftuarjen e shoqërisë civile apo të sektorit të pavarur të kulturës në grupe punuese. Megjithatë, anëtarët e shoqërisë civile janë të përfaqësuar në grupin punues, duke përfshirë anëtarët e Forumit Kulturor dhe pesë artistë të pavarur.⁷ Sipas MKRS-së, deri në fund të korrikut 2015 janë organizuar tri mbledhje të grupit punues, ndërsa propozim-dokumenti i parë pritet të jetë i gatshëm diku kah fundi i tetorit apo në nëntor.⁸ Procesi udhëhiqet përmes një akti administrativ, ku rregullohet mënyra e hartimit dhe miratimit të strategjisë.⁹

Përkundër planeve të Qeverisë për strategjinë e re të kulturës, si dhe për objektivat dhe veprimet e saj të planifikuara, Qeveria duket se ende po ka telashe në përcak-

timin e një politike të qartë të kulturës. Disa nga të intervistuarit kanë shprehur shqetësim se në vend që të punojnë nga qëllimet më të përgjithshme të politikave për të kaluar pastaj në objektiva dhe deri tek veprimet specifike, Qeveria e Kosovës vazhdon që aktualisht të punojë në drejtim të kundërt, duke filluar nga veprimet apo aktivitetet në vend që të realizojë aktivitetet e udhëhequra nga politika. Përderisa mund të jetë më i lehtë planifikimi dhe realizimi i veprimeve të qarta sesa i qëllimeve të gjëra të politikave, kjo bën që përpjekjet e Qeverisë të duken si të ndërmarra në baza *ad hoc* dhe pa ndonjë vizion. Për të pasur një jetë kulturore të shëndoshë dhe stabile, Kosova ka nevojë që Qeveria të hartojë qëllime afatgjata të politikave për sektorin e kulturës dhe të mundësojë që përmes këtyre qëllimeve të drejtohen aktivitetet.

Në mënyrë që Qeveria të mund të hartojë një politikë të mirë të kulturës, duhet ta ketë vizionin se ku duhet të jetë pozita e jetës kul-

2015; intervistë me Vehbi Miftarin.

7 Intervistë me Vehbi Miftarin.

8 *Po aty*.

9 Udhëzimi administrativ nr. 02/2012 për procedurat, kriteret dhe metodologjinë për hartimin dhe miratimin e dokumenteve strategjike dhe planeve për zbatimin e tyre, 23 mars 2013, http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Draft_Udhezimi_Administrativ_Per_Strategjiite_FINAL_2012_2_.pdf.

turore në Kosovë për një afat më të gjatë. Për ta ndihmuar këtë proces, është sugjeruar që Qeveria të bëjë një hulumtim, ku do të përfshiheshin akterë të kulturës nga të gjithë sektorët, shoqëria civile, ekspertët e fushës, etj. Në kuadër të këtij hulumtimi duhet të analizohen në mënyrë të duhur politikat kulturore të vendeve të tjera, posaçërisht të shteteve anëtare të BE-së, pasi që Kosova është në rrugëtimin e saj drejt integritimit në BE.¹⁰ Disa gjithashtu kanë sugjeruar që Qeveria duhet të sigurohet që të identifikojë sektorët e kulturës në Kosovë për të parë se ku janë të nevojshme investimet dhe ku ka talente më së shumti. Identifikimi i industrive kreative është bërë në kuadër të projektit Kultura për të gjithë,¹¹ por i njëjti tanimë mund të jetë vjetërsuar, dhe Qeveria duhet të bëjë identifikimin e të gjithë sektorëve. Qeveria po ashtu mund të

kërkojë ndihmesën në hartimin e politikës kulturore nga organizatat e pavarura të kulturës të shteteve anëtare të BE-së, siç është organizata Nätverkstan në Suedi. Kur u kontaktua, organizata Nätverkstan shprehu gatishmërinë t'i ndihmojë Qeverisë në hartimin e politikës së kulturës, si dhe të mbajë punëtori, kurse, etj, për ministrat dhe shërbuesit civilë të MKRS-së lidhur me politikën e kulturës.¹²

10 Intervistë me David Karlsson.

11 'Raporti për vlerësimin e industrive kreative' dhe 'Raporti për identifikimin e sektorëve të kulturës', Kultura për të gjithë (Culture for All), 2010-2012, <http://www.culture-ks.org/pdf/creative%20industries%20and%20mapping%20report.pdf>.

12 Sipas David Karlsson, Nätverkstan do të ishte i gatshëm t'i ndihmojë qeverisë në hartimin e politikës së kulturës.

Diskutimi në panelin e konferencës

Drejtimesja e panelit, Shqipe Haxhredini, hapi konferencën dhe diskutimin në Panel përmes një numri pyetjesh. A ka politikë për kulturë në Kosovë? A ka orientim strategjik për kulturë? Nëse po, cili orientim strategjik ekziston? Çfarë praktikash regjionale apo evropiane janë dëshmuar si funksionale në vendet fqinje? A është Ministria duke i këmbyer praktikat? A ekziston komunikim i qartë dhe i rregullt mes institucioneve, sektorit të pavarur dhe atij publik? Deri në çfarë mase ky lloj komunikimi ka ndikim të drejtpërdrejtë në vendimmarrje për qytetarët e Kosovës në sfidimin dhe ndryshimin e politikave lokale në kulturë?

Në disa nga këto pyetje është tentuar dhënia e përgjigjeve përmes një numri dokumentesh të politikave, të botuara gjatë vitit 2015 nga Forumi Kulturor. Përveç kësaj, në kuadër të konferencës është tentuar dhënia e kontributit në këtë debat. Megjithatë, gjetjet tregojnë se kultura në Kosovë mbetet në margjinat e

politikave publike dhe si e fillë është edhe ngarkesë për buxhetin e shtetit. Përkundër nismave të ndërmarra gjatë vitit 2015, Kosova ende nuk ka miratuar strategjinë nacionale për kulturë, duke lënë kështu një boshllëk, ku institucionet publike janë të favorizuara me rastin e ndarjes së buxhetit. Në vitin 2015 vazhdimisht është shprehur pakënaqësi nga ana e komunitetit të pavarur të artistëve si rrjedhojë e disa vendimeve të marra nga MKRS-ja.

Përfaqësuesi i Ministrisë së Kulturës, Faton Peci, paraqiti shifrat financiare, përmes të cilave pasqyrohet situata e gjetur në Ministri që nga fillimi i mandatit të LDK-së. Gjithsej shuma e borxheve ka qenë përafërsisht 1.5 milion euro. Ai shtoi se Ministria ka caktuar disa qëllime të 'politikave' përmes ndërhyrjes në ndarjen e projekteve. Ministria beson se çdo sektor duhet të trajtohet në mënyrë të barabartë (qofshin institucione publike apo të pavarura).

Lidhur me strategji, është vërejtur se grupet punuese janë formuar

për të trajtuar disa nga sfidat në kulturë përmes fillimit të hartimit të dy strategjive (Strategjisë për kulturën 2016-2020 dhe Strategjisë për trashëgiminë kulturore). Pakënaqësia është shprehur lidhur me dinamikën e punës së këtyre dy grupeve punuese, por njëkohësisht është shprehur edhe vullneti për të bashkëpunuar me Forumin Kulturor (përmes përfshirjes së dy anëtarëve në grupet punuese).

Florent Mehmeti, kryetar i Forumit Kulturor, foli për punën e deritashme të bërë nga Forumi Kulturor, duke shtuar se politikat e kulturës vazhdimisht po shpërfillen. Ai argumentoi se kultura po përdoret si instrument politik dhe se thirrja e fundit e aplikimit për projekte vetëm se e vërteton këtë deklaratë. Në një dokument të mëhershëm të Florent Mehmetit, të botuar nga Forumi Kulturor, ai argumenton se pasi që tërë shoqëria e Kosovës ka jetuar në një sistem paralel gjatë viteve 1990-të, pra jashtë institucioneve të regjimit, pas çlirimit, etja për institucional-

izimin e jetës është shndërruar në mani dhe pas një kohe ka kaluar në fobi, gjë që nuk ka lejuar që proceset të zhvillohen në drejtimin normal dhe sipas mënyrës së diktuar nga “tregu i kulturës”. Administrata e UNMIK-ut, e cila për nga natyra ishte tejburokratike, i ka kontribuar shumë kësaj. Me shpresën se ky lloj ngërçi do të zbutet pas shpalljes së pavarësisë dhe marrjes së përgjegjësisive të plota nga institucionet vendore, në fakt ka ndodhur e kundërta – institucionet vendore në qëllimin e tyre për të themeluar dhe fuqizuar shtetin vazhduan më tej drejt institucionalizimit si fenomen dhe burokraci dhe si mënyrë e “rritjes” së rëndësisë së shtetit dhe instrumenteve të tij. Derisa ky fenomen madje mund të japë fryte në sektorë të tjerë, në sektorin e kulturës ka ndikim të gjerë, duke ngurtësuar dhe denigruar cilësinë, si dhe krijon pengesa të mëdha në jetën kulturore në përgjithësi. Për çdo problem që mund të dilte në sektor, do të bëhej përpjekja që të zgjidhet

përmes në akti ligjor apo nënligjor juridik dhe më pastaj autoritetet kanë shfrytëzuar këtë për t'u fshehur dhe për të deklaruar se nuk kanë mjete juridike për të "ndihmuar" apo "përmirësuar" diçka. Në fenomen i tillë ka ndodhur në kohën kur janë ndalur financimet për teatrin e qytetit nga ana e nivelit qendror, përmes hartimit të akteve nënligjore që janë pasuar nga Ligji për teatrot, ku parashihet që financimi i teatrove të jetë nën përgjegjësi të plotë të komunave. Ministria e Kulturës i financonte ato sipas parimit *ad hoc* përmes një shume të caktuar, të ndarë për teatro të ndryshme të qytetit pa vlerësuar fuqinë, madhësinë e as seriozitetin e këtyre teatrove, të cilat në fakt kanë dalime të mëdha në mes vete. Duke u thirrur gjithnjë në pretendimin se ligji dhe obligimet e tjera ligjore nuk lejojnë financimin më të madh të institucioneve, qofshin ato publike apo të pavarura, është dhënë përshtypja se vlera e projekteve të propozuara dhe potenciali i këtyre

institucioneve është shumë e mirë dhe domethënëse, por janë pengesat ligjore ato që nuk lejojnë financime më të mëdha.

Violeta Simjinovska, paneliste mysafire nga Maqedonia tha se vendi i saj po përpiqet të definoj dhe ridefinojë politikat e kulturës në 15 vitet e fundit, por se ndikimi pozitiv ka qenë i vogël. Projekti "Shkupit 2014" është shembull eklatant se si kultura mund të përdoret për qëllime politike. Strategjitë për kulturën, grupet punuese, etj, janë dëshmuar si të paefektshme në ndryshimin dhe hartimin e një politike të mirë të shtetit për kulturën. Qeveria nuk ka marrë parasysh asnjërin prej propozimeve dhe ekspertizën e ofruar nga sektori i pavarur e organizatat joqeveritare. Kosova nuk duhet t'i përsëris gabimet e njëjta që IRJM-ja i ka bërë, shtoi ajo. Tendencat nacionaliste në kulturë janë në ngritje e sipër në vendet e Ballkanit (një shembull mund të jetë 'Beogradi në ujë', politika e kulturës e Malit të Zi, IRJM-ja, etj.), ku këto tenden-

ca nuk janë duke prodhuar asgjë turore. substanciale në kulturë, përpos kiçit dhe vlerave antikulturore.

Zana Hoxha nga ArtPolis tha që pjesëmarrja në grupin punues për hartimin e Strategjisë për kulturë ka qenë proces sfidues për të gjithë anëtarët. Procesi ka pasur mjaft kufizime, duke lënë jashtë pjesëmarrjes publikun në përgjithësi dhe komunitetet. Qasja e Forumit Kulturor ka qenë mjaft e drejtpërdrejtë. Nga ana tjetër, duket se nuk ka pasur interesim për pjesëmarrje prej anëtarëve të institucioneve të emëruar si anëtarë të grupit punues. Eroll Bilibani nga Dokufest-i solli shembuj të vështirësive në organizimin e ngjarjes më të madhe kulturore në Kosovë. Ai gjithashtu foli për rrjetëzimet lokale në fushën e kulturës në Prizren, duke theksuar sfidat ,e të cilat ballafaqohet skena e pavarur e kulturës në strukturimin e dialogut me pushtetin lokal për shkak të moskuptimit dhe mungesës së vullnetit nga ana e zyrtarëve lokalë për miratimin e politikës kul-

Forumi kulturor

Gjatë fundit të vitit 2011, Teatri Oda ka mbajtur takime të shumta me qëllim të themelimit të rrjetit të organizatave të kulturës në Kosovë. Në këto takime kanë marrë pjesë më shumë se 60 pjesëmarrës, përfaqësues të organizatave të ndryshme të kulturës, duke krijuar kështu mundësinë për të organizuar Kuvendin themelues për 23 mars 2012, ku u vunë themelet për Rrjetin e Organizatave të Pavarura të Kulturës – Forumi Kulturor. Kuvendi themelues vuri themelet e Forumit Kulturor me 22 organizata të pavarura si anëtare. Përmes votimit demokratik është miratuar Statuti dhe gjithashtu është zgjedhur kryesia e Rrjetit. Forumi Kulturor është entitet i regjistruar si rrjet i organizatave të pavarura të kulturës. Këtu është vendosur që rolin e Sekretarisë së përkohshme ta merr Teatri Oda deri në krijimin e kapaciteteve për formimin e sekretarisë profesionale të rrjetit.

Forumi Kulturor i Kosovës është rrjet i organizatave të pavarura të

kulturës në Kosovë, i themeluar me qëllim të:

- Fuqizimit të organizatave të pavarura të kulturës përmes zhvillimit të kapaciteteve për zbatimin e programeve të tyre;
- Promovimit të organizatave anëtare;
- Përfshirjes së organizatave anëtare në vendimmarrje;
- Rritjes së përkrahjes për skenën e pavarur kulturore;
- Mbrojtjes dhe përmirësimit të pozitës së organizatave kundruall institucioneve përkatëse në Kosovë dhe jashtë saj.

Forumi kulturor ka për qëllim të plotësojë misionin e tij përmes aktiviteteve si në vijim:

- Komunikimin dhe rrjetëzimin e organizatave të pavarura të kulturës;
- Këmbimin dinamik të informatave dhe të përvojës;
- Aktivitetet e lobimit dhe avokimit;
- Trajnime specifike për nevo-

jat e organizatave anëtare;
-Organizmin e debateve dhe
forumeve dhe
-Bashkërendimin e aktiviteve artistike dhe të kulturës.

Forumi për zhvillimin e kulturës

Forumi për Zhvillim Kulturor është projekt që ka për qëllim të zhvillojë dhe fuqizojë më tej Forumin Kulturor të themeluar në vitin 2012, duke dhënë këshilla dhe ekspertizë të vlefshme për politikën kulturore të Kosovës. Projekti përkrahet nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, ndërsa zbatohet nga Forumi Kulturor, Teatri Oda dhe Dokufest-i. Aktivitetet e para të projektit u realizuan në dhjetor të vitit 2013. Projekti parashihet të zgjasë deri në nëntor 2015. Gjatë kësaj periudhe dyvjeçare, Forumi për Zhvillim Kulturor do të del me së paku 28 produkte të politikave kulturore, të cilat do të rezultojnë nga hulumtimet, debatet, grupet e fokusit dhe konferencat. Në kuadër të projektit gjithashtu do të fuqizohet rrejtja e organizatave të pavarura të kulturës, do të ndërtohen kapacitete e tij të brendshme dhe do të ndikohet në zhvillimin e politikave të kulturës në Kosovë duke krijuar dije për kulturën. Përveç kësaj, në kuadër të projektit do të nxitet dialogu dhe

bashkëpunimi mes sektorit të kulturës së pavarur dhe autoriteteve publike në mënyrë që të gjenden zgjidhjet konkrete për zhvillimin e kulturës në Kosovë.

www.forumikulturor.net




Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë



Implementuar nga:





forumikulturor.net
facebook.com/ForumiKulturor
twitter.com/forumikulturor